

KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletëpërgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë A B C D

Gabim A B C D

- Bëni kujdes për të mos dalë jasht rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si zhgarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan "PERGJIGJET".
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Kodoni me kujdes preferencat tuaja për shkollat në të cilat dëshironi të studioni. Rezultatet dhe bursat do të shpallen sipas preferencave të bëra.

Shkolla	Kodi
"Mehmet Akif" e Mesme - Vajza në Tiranë (me konvikt)	01
"Mehmet Akif" e Mesme - Djem në Tiranë (me konvikt)	02
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Tiranë (me konvikt)	03
"Hasan Riza Pasha" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Shkodër (e mesme me konvikt)	04
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Durrës (klasat 9-12 me konvikt)	05

Nxënësit që studiojnë në kolegjet Turgut Özal dhe Hasan Riza Pasha nuk kanë të drejtë të hyjnë në këtë provim!

Suksese!

1.

Në figurën e dhënë janë shënuar masat e dy këndeve 70° dhe 110° ; drejtëza d_1 është paralele me d_2 . Cilat prej këndeve të tjera kanë masën 70° ?




Figura nuk është ndërtuar me saktësi

- A) $\angle 4, \angle 6, \angle 8$ B) $\angle 3, \angle 5, \angle 7$
 C) $\angle 3, \angle 5, \angle 8$ D) $\angle 4, \angle 5, \angle 8$

2.

Cila nga alternativat e mëposhtme është forma thjeshtuar e shprehjes $5m(2k-m)-2k(5m-k)$?

- A) $2k^2-5m^2$ B) $5m^2-2k^2$
 C) $2k^2+5m^2$ D) $2k^2+15km-5m^2$

3.

60% e nxënësve të një klase me 35 nxënës janë djem. Nëse largohen 10 djem nga klasa, sa përqind e nxënësve të mbetur në klasë janë vajza ?

- A) 40 B) 45 C) 50 D) 56

4.


Renditni thyesat e mëposhtme nga më e madhja te më e vogla.

$$a = \frac{7}{5}, b = \frac{6}{7}, c = \frac{7}{8}, d = \frac{8}{9}$$

- A) d,b,c,a B) a,d,c,b
 C) a,d,b,c D) a,b,c,d

5.

$AK \parallel BD$ dhe $m\angle BAC = m\angle CAD$ atëherë $m\angle KAD = ?$



- A) 10° B) 20° C) 30° D) 40°

6.

Fatjoni mendoi një numër. Këtij numri i shtoi 2 dhe pastaj rezultatin e shumëzoi me 3. Rezultati ishte njësoj si t'i shtoni 5 numrit, pastaj të shumëzoni rezultatin me 2. Çfarë numri ka menduar Fatjoni ?

- A) 4 B) 6 C) 8 D) 10


7.

Cila nga alternativat e mëposhtme është drejtëz e simetrisë?

- A) B) C) D)

8.

Jepen katrorët ABFH dhe CDEF si në figurë, $|BC| = 5\text{cm}$, sipërfaqja e katrorit CDEF është 9cm^2 . Sa është sipërfaqja e katrorit ABFH ?



- A) 25 B) 36 C) 49 D) 64

9.

Sa është vlera e shprehjes $3x-5y$; kur $x=5$ dhe $y= - 3$.


- A) 0 B) 15 C) 30 D) 60

10.

$$\sqrt{4} - \sqrt[3]{27} + \sqrt{169}=?$$

- A) 6 B) 12 C) 17 D) 26

11.



Në grafikun e mësipërm jepen shitjet e veturave dhe kamionave nga viti 2010 deri në vitin 2014 . Cila nga të mëposhtmet është e saktë sipas grafikut ?

- A) Në pesë vite janë shitur total 2350 vetura.
 B) Në vitin 2010 janë shitur 400 vetura dhe 150 kamjona.
 C) Më shumë vetura janë shitur në vitin 2010.
 D) Në vitin 2013 janë shitur 300 vetura dhe 450 kamjona

12.

Raporti i masave të këndeve të brendshëm të një trekëndëshi është $9:12:15$. Sa është masa e këndit më të madh ?

- A) 45 B) 60 C) 75 D) 90


13.

Hidhen dy zare të rregullta njëherësh. Sa është probabiliteti që shuma e pikave të rëna të jetë më e vogël se 9 ?

- A) $\frac{10}{36}$ B) $\frac{26}{36}$ C) $\frac{4}{12}$ D) $\frac{8}{12}$

14.

Cila nga figurat e mëposhtme është grafiku i funksionit $y=2x+4$?



15.

Sa është shumëfishi më i vogël i përbashkët 6, 8, 10.

- A) 2 B) 48 C) 60 D) 120

16.

Kufiza e parë e një vargu është 15. Rregulli i përfutimit të vargut është: 'shtoni 7'. Cila është kufiza e 15-të e vargut?

- A) 113 B) 120 C) 225 D) 232

17.

$$\left(1 + \frac{1}{2}\right) \cdot \left(1 + \frac{1}{3}\right) \cdot \left(1 + \frac{1}{4}\right) \cdot \left(1 + \frac{1}{5}\right) = ?$$

- A) $\frac{3}{2}$ B) 3 C) $\frac{6}{5}$ D) 6

18.

Sa është vlera e x-it nëse
 $3(x-5) - 2(3-2x) = 5(7-3x)$

- A) $\frac{7}{11}$ B) 1 C) 2 D) $\frac{28}{11}$

19.

Mesatarja aritmetike e gjashtë numrave të dhënë në kutinë e mëposhtme është 15; sa është amplituda ?

12	8	7	x	24	14
----	---	---	---	----	----

- A) 18 B) 22 C) 25 D) 28

20.

Fatjoni mendoi një numër . Ai e shumëzoi numrin me 0,2 dhe rezultatin e pjestoi me 0,1 . Më pas rezultatin e ri e pjestoi me 0,2 dhe mori rezultatin përfundimtar 500. Cili është numri që mendoi Fatjoni në fillim ?

- A) 500 B) 50 C) 10 D) 5

21.

$$27,32 - 19,64 = ?$$

- A) 46,96 B) 7,58
 C) 7,68 D) 7,78

22.

$$(-4) \cdot (-9) + (-2) = ?$$

- A) -38 B) -34 C) +34 D) +36

23.

Sa është shuma e 15%-it dhe 60%-it të 300?

- A) 135 B) 180 C) 200 D) 225

24.

Numri i vezëve për kuti	Çmimi
1	100 Lëkë
6	350 Lëkë
12	499 Lëkë
18	589 Lëkë

Bazuar në tabelën e mësipërme, cila nga alternativat e mëposhtme është shuma minimale për të blerë 100 vezë ?

- A) 3695 B) 4392
C) 6000 D) 10000



25.

Sa është ndryshesa e numrit treshifror më të madh me numrin treshifror më të vogël ?

- A) 1099 B) 900 C) 899 D) 800

26.



Cila nga alternativat e mëposhtme është forma e hapur e kubit?



A) B) C) D)


27.

Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?



28.



Cili numër duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?



A) 38 B) 39 C) 41 D) 47


29.

Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?



30.


Cili numër duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?







- A) 73 B) 88 C) 89 D) 92

31.


Cila figurë duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?







- A)  B)  C)  D) 

32.


Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?



- A)  B)  C)  D) 
- A) B) C) D)

33.


Cili numër duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?







- A) 66 B) 64 C) 62 D) 60

34.


Cila nga të mëposhtmet është pamja e figurës nga pika P ?



- A) 
- B) 
- C) 
- D) 

35.

Sa kube janë në figurën e mëposhtme?



- A) 25 B) 26 C) 27 D) 28

66.

Në fjalinë “*Në klasë kemi një djalë, i cili vizaton shumë bukur.*”, kryefjala shprehet me:

- A) emër
- B) përemër lidhor
- C) grup emëror
- D) emër me parafjalë

67.

Romani “*Djemtë e Rrugës Pal*” është shkruar nga:

- A) Ferenc Molnar
- B) Franc Kafka
- C) Dino Buxati
- D) Isak Asimov

68.

Dalloni grupin e fjalëve që kanë të njëjtën morfemë rrënjore:

- A) atdhe, atdhedashuri, mëmëdhe
- B) përdhe, nëntokë, dashuri
- C) sipërfaqe, nëntokësor, nënkresë
- D) lulëzoj, vlerësoj, dorëzoj

69.

Morfemat trajtëformuese shërbejnë për të formuar:

- A) Trajta të ndryshme të së njëjtës fjalë.
- B) Fjalë të reja.
- C) Fjalë të përbëra.
- D) Fjalë të përngjitura.

70.

Janë përemra lidhorë:

- A) që, i cili, e cila
- B) cili, cila, cilët
- C) unë, ti, ai, ajo
- D) im, jote, e tij, e saj

71.

Kuptimi i figurshëm metaforik nuk krijohet kur emri i një sendi a dukurie kalon si emërtim i një sendi a dukurie tjetër sipas ngjashmërisë në:

- A) tipare
- B) formë
- C) kalimin e cilësive të një frymori te një jofrymor
- D) zëvendësimin e shkakut me pasojën

72.

Cila prej rasave nuk ka parafjalë:

- A) emërore
- B) gjinore
- C) dhanore
- D) rrjedhore

73.

Cila nga alternativat ka lidhëza lejore:

- A) edhe pse, ndonëse, megjithëse
- B) dhe, edhe, por, kurse
- C) se, që
- D) kështu që, sepse, nëse

74.

Janë personazhe në pjesën “Nata e Ustikës”:

- A) Boka, Nemeçeku, Gerebi
- B) Sonja dhe Andrea
- C) Stefan Roji dhe babai
- D) Aleksandër Adell dhe Bertram Lupov

75.

“Martesa me Orën – zonjë” është shkëputur nga libri:

- A) “Majat e Shalës”
- B) “Shkëmbi i Skënderbeut”
- C) “Liqeni i luleve”
- D) “Gërzheta”

76.

Janë pjesëza që vijnë nga ndajfoljet:

- A) edhe, pra, sa, se
- B) gati, plot, rreth, vetëm
- C) desh, le
- D) u, jo, ja, dhe

77.

Në cilën nga fjalitë kemi kallëzues të përbërë:

- A) Dielli shkriu retë e zeza.
- B) Nëna ime kishte ardhur në shkollë.
- C) Iliri nuk pushonte së foluri.
- D) Paskan ardhur të gjithë sot!

78.

“Bota e Sofisë” është roman:

- A) Shoqëror
- B) Fantastiko-shkencor
- C) Historik
- D) Filozofik

79.

Vargjet “Një në prak e një në derë,/ plasën si qelqe me verë.”, janë shkëputur nga pjesa:

- A) “Kush e solli Doruntinën”
- B) “Kënga e Dhoqinës”
- C) “Arnaut Osmani”
- D) “Besa e Kostandinit”

80.

Nuk është shkallë e mbiemrit, shkalla:

- A) pohore
- B) krahasore
- C) emërore
- D) sipërore

81.

Pjesa “Pyetja e fundit” i përket llojit letrar të:

- A) Poemës epike
- B) Esesë argumentuese
- C) Esesë së krahasim-kontrastit
- D) Romanit fantastiko-shkencor

82.

“Befasinë artistike” e gjejmë të përdorur në pjesën:

- A) “Kolombreja”
- B) “Pyetja e fundit”
- C) “Një kryqëzim”
- D) “Djemtë e Rrugës Pal”

83.

“Një vend i ngritur buzë arës për të penguar ujërat”, quhet:

- A) përdheskë
- B) ulicë
- C) mezhde
- D) stere

84.

Nuk përfshihen në gjininë epike:

- A) epi, epopeja, baladat
- B) miti, fabula, përralla
- C) poezitë, himni, lirika
- D) romani, novela, tregimi

85.

Cila nga pjesët e mëposhtme është shkruar nga Homeri:

- A) “Kush e solli Doruntinën”
- B) “Kënga e Dhoqinës”
- C) “Arnaut Osmani”
- D) “Kthimi i Odisesë”

86.

Nyja përdoret në vend të përemrit pronor te:

- A) emrat e rasës gjinore
- B) emrat e farefisnisë
- C) emrat e gjinisë asnjëanëse
- D) emrat në numrin shumë

87.

Dalloni përcaktorin me bashkim:

- A) Ata janë burra të gojës.
- B) Ai kishte një dinakëri dhelpre.
- C) Ne jemi pasardhës të tyre.
- D) Dëshira për të lexuar ishte shumë e ethshme.

88.

Shkalla sipërore e ndajfoljeve nuk ndërtohet:

- A) Me ndihmën e një ndajfoljeje tjetër.
- B) Duke përsëritur të njëjtën ndajfolje.
- C) Me pjesëzën “më”.
- D) Me fjalët “shumë, tepër, fare, mjaft”.

89.

Nuk e formojnë formën joveprore me pjesëzën “u” foljet në mënyrën:

- A) dëftore e habitore
- B) lidhore e kushtore
- C) habitore e dëshirore
- D) dëftore e dëshirore

90.

Gjymtyra e nënvizuar në fjalinë “*Në muajin qershor do të shkojmë jashtë shtetit.*” është:

- A) kundrinor i drejtë
- B) përcaktor
- C) ndajshtim
- D) kundrinor i zhdrejtë me parafjalë

